

**VENDIM**  
**Nr. 313, datë 12.12.2025**

**MBI LËNIEN NË FUQI PËR VITIN 2026 TË TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SHA, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, pika 1, 16 pika 2, 17, germa “e” dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2392/1 prot., datë 10.12.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Drejtoria e Gazit Natyror “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, ‘Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2026’”,

konstatoi se:

- Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga “Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s, si dhe nga “Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 8.11.2017, ERE i ka kërkuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. paraqitjen e një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, të shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi, përmes shkresës nr. 2362 prot., datë 26.8.2025.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 96/1 prot., datë 1.9.2025, protokolluar pranë ERE-s me nr. 2392 prot., datë 2.9.2025, ka bërë me dije se, në rrethanat në të cilat zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, nuk ka pasur zhvillime domethënëse që do të ndikonin drejtpërdrejt në elementet përbërëse të metodologjisë së tarifës së transmetimit dhe, për rrjedhojë, ka kërkuar që edhe për vitin 2026 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, ka nisur procedurën për shqyrtimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve të “Albgaz” sh.a., ndërsa me vendimin nr. 277, datë 13.12.2024, ka shtyrë vendimarrjen deri në dhjetor 2025.

- Tarifa e transmetimit të gazit natyror përlllogarit, ndër të tjera, mbi bazën e investimeve të parashikuara në planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të “Albgaz” sh.a.

- “Albgaz” sh.a., në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim për miratimin e një tarife të re transmetimi, sipas legjislacionit dhe metodologjisë në fuqi.

- Në vijim të procedurës, ERE i është drejtuar “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 2852 prot., datë 13.11.2025, për dorëzimin e dokumentacionit plotësues për vijimin e procedurës së miratimit të planit dhjetëvjeçar (2023–2032).

- Me shkresën nr. 119/1 prot., datë 27.11.2025, “Albgaz” sh.a. ka kërkuar shtyrjen e miratimit të planit dhjetëvjeçar deri në dhjetor 2026, duke sqaruar se ndodhet në një fazë të rëndësishme zhvillimi të sistemit të gazit natyror.

- Neni 17, germa “e”, i ligjit nr. 102/2015, parashikon kompetencën e ERE-s për miratimin e tarifave të përkohshme të transmetimit dhe vendosjen e masave kompensuese, në rast vonesash ose diferencash me tarifat përfundimtare.

- Në mungesë të një aplikimi për tarifë të re, dhe duke qenë se tarifa e transmetimit është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit dhe garantimin e aksesit në rrjet, vlerësohet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, edhe për vitin 2026, deri në miratimin e një tarife të re sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së transmetimit të gazit natyror miratuar me vendimin nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**